

# Doracak për tastierën Plisi D

nga Plisi.al

---

## Përmbajtja

I.	Hymje.....	1
II.	Tastiera mekanike dhe përvijimet .....	2
	A. Tastiera mekanike .....	2
	B. Përvijimet .....	2
	1. Plisi D1.....	2
	2. Plisi D2.....	3
III.	Softweri për përvijimet .....	3
	A. Parakushtet teknike.....	3
	B. Kushtet e përdorimit .....	4
	C. Qysh me e ba gati?.....	4
	1. Shkarko skedarin .....	4
	2. Instaloje .....	4
	3. Zgjedhe përvijimin që don .....	4
	D. Qysh me e përdorë? .....	5
IV.	Radhitja e karaktereve .....	5
	E. Togu parsor .....	5
	4. Niveli i parë – Rasa e poshtme .....	5
	5. Niveli i dytë – Rasa e epërme .....	6
	6. Niveli i tretë.....	6
	F. Togu dytsor .....	8

---

## I. HYMJE

Parahedhja «Plisi D» për tastierën shqipe mundëson dy zgjedhje. Përvijimi Plisi D1 asht i thjeshtë dhe kufizohet vetëm në nevojat ma themelore të gjuhës shqipe. Plisi D2 përmban mbi njëqind karaktere shtesë që mund të shërbejnë për ta shkruar gati secilën gjuhë që e përdor alfabetin latin.

Përvijimet mund të përdoren në tastierën fizike amerikane (*US Keyboard*) dhe në tastierën fizike të standardit ndërkombtar (ISO). Plisi D1 dhe Plisi D2 mbështeten në radhitjen softwerike të përvijimit amerikan (US Layout) me përshtatje shtesë nga standardi shqiptar dhe standardi gjerman (T2).

Parahedhja Plisi D synon me vendosë një standard të ri mbarëkombtar, që i zgjidh të metat e tastaturave të maparshme shqiptare, tue pasë parasysh nevojat dhe parapëlqimet e përdoruesve si dhe gjendjen në treg. Plisi asht emni i websajtit, me adresë Plisi.al, ku mund t’i shkarkosh fajllat për instalimin e tastierës shqipe në komputorin tand. Germa D asht për Dardaninë.

## II. TASTIERA MEKANIKE DHE PËRVIJIMET

### A. TASTIERA MEKANIKE

Tastiera shqipe Plisi D ka për bazë tastierën mekanike amerikane (*US Keyboard*) të përkufizueme me standardin kombtar ANSI-INCITS 154-1988 (R2004) të Shteteve të Bashkueme. Plisi D po ashtu përputhet me standardin ndërkombtar ISO/IEC 9995-1:2009, simbas të cilit prodhohen shumica e tastierave për shitje në vendet evropiane.

### B. PËRVIJIMET

Plisi D ka dy përvijime. Këto mbështetën pikë së pari në përvijimin amerikan (*US Layout*) me përshtatje shtesë të nevojshme për gjuhën shqipe. Përshtatjen marrin për bazë standardin shqiptar të vitit 1993 dhe standardin T2 për përvijimin e tastierës gjermane, përkufizue nga DIN 2137:2012-06.

Dy përvijimet përputhen edhe me standardet ndërkombtare ISO/IEC 9995-2:2009 dhe/ose ISO/IEC 9995-3:2010.

#### 1. Plisi D1

Përvijimi Plisi D1 asht i thjeshtë dhe kufizohet vetëm në nevojat ma themelore të gjuhës shqipe.

~ `	! 1	@ 2	# 3	\$ 4	€ 5	% 6	& 7	{ 8	} 9	[ 0	] -	= +	Backspace ←
Tab ⇐ ⇨	Q	W	E	R	T	Y	U	I	O	P	Ç	< >	 \ /
Caps Lock ⇧	A	S	D	F	G	H	J	K	L	Ë	" ,	Enter ↵	
Shift ⇧	Z	X	C	V	B	N	M	;	:	? ,	/	Shift ⇧	
Ctrl	[S.O.]	Alt						AltGr	[S.O.]	Meny	Ctrl		

Skica 1. Përvijimi Plisi D1

## 2. Plisi D2

Plisi D2 përfshin të gjitha karakteret e përvijimit Plisi D1 si dhe një nivel dhe grup shtesë karakteresh huazue me pak ndryshime nga standardi gjerman T2.<sup>1</sup> Përvijimi Plisi D2 mund të shërbejë me shkruar gati secilën gjuhë që e përdor alfabetin latin.

~	!	@	#	\$	%	^	&	*	(	)	-	+ -	Backspace
`	1	2	3	4 €	5 ;	6 ;	7 {	8 }	9 [	0 ]	- (→)	= ®	←
Tab	Q °	W	E œ	R	T	Y	U	I ı	O ø	P þ	Ç f	<	!
	°	ö	ô	ö	ö	ö	ö	ö	ö	ö	ö	>	\ ♂
Caps Lock	A æ	S	D ð	F	G	H	J	K	L ł	Ë	" ð	Enter	←
	≤	≥	ø	'	"	§	♀	♀	♀	♀	'	←	←
Shift	Z ß	X „	C	V “	B ”	N	M μ	; ...	: .	?	Shift	Shift	↑
	«	»	©	<	>	-	-	,	'	.	/	↑	↑
Ctrl	[S.O.]	Alt					NNBSP	AltGr	[S.O.]	Meny	Ctrl		
							NBSP						

Skica 2. Përvijimi Plisi D2

**Kujdes:** Radhitja e butonave në skicat 1 dhe 2 asht simbas tastierës fizike amerikane (*US Keyboard*), e cila dallon mund të dallojë nga tastaturat e vendeve tjera. Në tastierat fizike simbas standardit ndërkombtar (ISO):

- Ka një buton shtesë në mes të Z-së dhe ndërruesit të majtë (*Shift*). Në përvijimet Plisi D1 dhe Plisi D2, ai buton nxjerr shenjat «ma i/e vogël» (në rasën e poshtme) dhe «ma i/e madh/e» (në rasën e epërme).
- Tasti i futjes (*Enter*) asht ma i ngushtë, ka trajtën e gjashtëkëndëshit konkav dhe zen dy rinde (përkatësisht rreshtin e dytë dhe të tretë të çelësave).
- Butoni për kundërthyesë (\) dhe shkop (*bar |*) ndodhet në rreshtin e tretë, menjëherë në të majtë të tasterit të futjes (*Enter*). Në tastierën amerikane, ky buton ndodhet në skajin e djathtë të rreshtit të dytë, poshtë prapakthyesit (*Backspace*) dhe sipër futjes (*Enter*).

## III. SOFTWARERI PËR PËRVIJIMET

Plisi.al ka përgaditë dy programe kompjuterike që mundësojnë me përdorë tastierën Plisi D në kompjuterë vetjakë.

### A. PARAKUSHTET TEKNIKE

Për ta përdorë cilindo nga programet për tastierën Plisi D, sigurohu që kompjuteri yt ka:

<sup>1</sup> Shih po ashtu Karl Pentzlin, «Information about the Revision of ISO/IEC 9995-3» (2010-10-23) <<http://www.pentzlin.com/info2-9995-3-V3.pdf>>.

- Sistemin operativ: Microsoft Windows (XP, Vista dhe 7)
  - Ma parë na kanë njoftue disa përdorues se nuk kanë mujtë me i instalue përvijimet në një komputor me Windows 8. Deri tani kemi arrijtë me i instalue përvijimet Plisi D1 dhe Plisi D2 në Windows 8.1, por kemi verejtë disa mangësi për tastierat e ekranit me prekje (touch screen).
  - Presim me i përshtatë përvijimet edhe për sistemet operative Linux dhe Apple OS.
- Tastierën fizike: në përputhje me standardin amerikan (US Keyboard) ose ndërkombtar (ISO)

## B. KUSHTET E PËRDORIMIT

Programet për përvijimet e tastierës Plisi D1 dhe Plisi D2 mund t'i shkarkosh, shpërndash dhe përdorësh falas.

Plisi.al shpreson që programet të vyejnë, por nuk jep kurrfarë garancie për to.

## C. QYSH ME E BA GATI?

### 1. Shkarko skedarin

Skedarët e programeve mund t'i shkarkosh nga websajti Plisi.al.

Zgjedh se cilin përvijim don me e instalue në sistemin tand dhe sharko skedarin përkatës.

### 2. Instaloje

Për ta instalue tastierën Plisi D – me vendosë përvijimin e tastierës në sistemin e programeve – komputori do t'i kërkojë të drejtat e administratorit ose mbarështuesit. Të drejtat tua mvaren nga lloji i llogarisë së përdoruesit të komputorit dhe nga parametrat që i përcakton sistemi operativ.

Mbasi të jesh i sigurve se i ke të drejtat e nevojshme, mund ta instalosh programin e tastierës.

Hap skedarin e shkarkuem. Skedari asht i programuem që vetë ta fillojë instalimin – që domethanë se komputori do ta vendosë përvijimin e tastierës në sistemin e programeve. Komputori mund të të kërkojë leje për ta instalue programin. Nëse n'ekran shfaqet një dritare dialogu, përgjigju «**Po**» (Yes). Komputori do ta instalojë përvijimin e dëshiruem shumë shpejt.

### 3. Zgjedhe përvijimin që don

Përvijimi i sapoinstaluem nuk do ta zavendësojë përvijimin e maparshëm (zakonisht përvijimi amerikan). Ti do të kesh mundësi me zgjedhë se cilin përvijim don me përdorë në çdo kohë.

Mbas instalimit të përvijimit të ri, në kandin e poshtëm në të djathtë t'ekranit, afër orës dhe datës, do të shfaqen një ikonë e vogël me dy shkronja – zakonisht EN (ose SQ). Kliko mbi te për ta ndërrue përvijimin nga tastiera e maparshme në Plisi D1 ose Plisi D2. Këte mund ta bash edhe tue shtypë njëkohësisht *Alt* (n'anën e majtë) dhe *Shift* në tastierë (nëse *Alt* + *Shift* nuk kryen punë, atëherë provo *Ctrl* + *Shift*).

Nëse nuk i tregon kompjuterit se cilin përvijim don ta përdorësh, sistemi vetvetiu do ta zgjedhë përvijimin e parazgjedhën (*default*). Ti mund ta caktosh vetë përvijimin e parazgjedhën. Mbas ta instalosh përvijimin e ri, tastiera e maparshme do të mbetet e parazgjedhuna.

Për shembull, për ta ba tastierën Plisi D1 përvijimin e parazgjedhën:

1. Kliko mbi ikonën e tastierës (zakonisht shkruen **EN** ose **SQ**) me sustën e djathtë të miut.
2. Mbasi të shfaqet një meny rrëshqitëse, kliko mbi **Parametrat** ose **Settings**.
3. Në krye të dritares, aty ku thotë «Gjuha e parazgjedhur» ose «Default input language», zgjedh nga lista rrëshqitëse gjuhën shqipe: **Shqip (Shqipëri) - Plisi D1** ose **Albanian (Albania) - Plisi D1**.
4. Kliko **Në rregull** ose **OK**.

Për udhizime ma të hollshme, shih faqen ndihmëse në sajtin e Microsoftit:

<http://support.microsoft.com/kb/258824> (anglisht)

Nëse vendos se Plisi D1 ose Plisi D2 nuk i përmbush nevojat tua, mund ta çinstalosh si çdo program tjetër në panelin e kontrollit në Windows.

## D. QYSH ME E PËRDORË?

Mbasi ta kesh instalue programin për njanin nga përvijimet dhe ta kesh përzgjedhë përvijimin që don, programi do të jetë gati për punë. Vetëm fillo me shtypë me tastierë si zakonisht.

Për veçoritë e përvijimeve Plisi D1 dhe Plisi D2 dhe udhizime se qysh me i përfutue karakteret e caktueme, shih sipri, Kreun «I. Përvijimet», si dhe ma poshtë, Kreun «III. Radhitja e karaktereve».

---

## IV. RADHITJA E KARAKTEREVE

Përvijimi i tastierës Plisi D1 përmban vetëm një tog ose grup karakteresh të ndamë në tri nivele. Niveli i tretë përfshin vetëm pesë karaktere.

Përvijimi i tastierës Plisi D2 përmban dy togje ose grupe karakteresh. Togu parsor përfshin karakteret ma të përdoruna dhe ndahet në tri nivele – secili me ma së paku 48 karaktere. Togu dytsor përmban karaktere shtesë me përdorim të posaçëm.



### A. TOGU PARSOR

#### 1. Niveli i parë – Rasa e poshtme

Niveli i parë përfshin karakteret që mund t'i përfutosh tue ndrydhë një buton të vetëm në tastierë. Në skicë, karakteret e këtij niveli janë të shënueme me ngjyrë të zezë n'anën e majtë të butonit. Niveli i parë përfshin shkronjat e vogla, numrat dhe – n'ato butona me ma shumë se një karakter – karakteret e shënueme në pjesën e poshtme të butonit.

Ndryshe, këto njihen si karaktere të rasës së poshtme (*lower case*).

Pothuejse secili buton do ta ketë të nejtën vlerë si në përvijimin amerikan me këto përshtatje kryesore simbas tastierës zyrtare të gjuhës shqipe:





- Germa **Ë** ndodhet në vend të pikëpresjes ( ; ), menjherë në të djathtë të L-së.  
Në tastierën fizike amerikane, ky buton asht i shënuem me .
- Germa **Ç** ndodhet në vend të kllapave kandore ( [ ] ) hapëse, menjherë në të djathtë të P-së.  
Në tastierën fizike amerikane, ky buton asht i shënuem me .
- Shenja «**ma i/e madh/e**» ( > ) ndodhet në vend të kllapës kandore mbyllëse ( ] ), menjherë në të djathtë të Ç-së (shih nalt).

## 2. Niveli i dytë – Rasa e epërme

Niveli i dytë përfshin karakteret që mund t'i përftohsh tue ndrydhë njikohësisht **ndërruesin** (*Shift*) dhe një buton tjetër. Në skicë, karakteret e këtij niveli janë të shënueme me ngjyrë të zezë n'anën e majtë të butonit. Niveli i dytë përfshin shkronjat e mëdha, karakteret sipër numrave dhe – n'ato butona me ma shum se një karakter – karakteret e shënueme në pjesën e epërme të butonit.

Ndryshe, këto njihen si karaktere të rasës s'epërme (*upper case*). Për germa të nivelit të dytë mund ta ndezësh kyçin e rasës (*Caps Lock*), por për simbole tjera duhet me përdorë ndërruesin.

Pothuejse secili buton do ta ketë të nejtën vlerë si në përvijimin amerikan me këto përshtatje kryesore simbas tastierës zyrtare të gjuhës shqipe:

- Germa **Ë** ndodhet në vend të dy pikave ( : ), menjherë në të djathtë të L-së.  
Në tastierën fizike amerikane, ky buton asht i shënuem me .
- Germa **Ç** ndodhet në vend të kllapave gjarpnore ( { } ) hapëse, menjherë në të djathtë të P-së.  
Në tastierën fizike amerikane, ky buton asht i shënuem me .
- Shenja «**ma i/e vogël**» ( < ) ndodhet në vend të kllapës gjarpnore mbyllëse ( } ), menjherë në të djathtë të Ç-së (shih nalt).
- Për **dy pikat** ( : ) shtyp njikohësisht *Shift* + pikë ( . ).  
Pika asht e shënueme në tastierën fizike amerikane me .
- Për **pikëpresje** ( ; ) shtyp njikohësisht *Shift* + presje ( , ).  
Presja asht e shënueme në tastierën fizike amerikane me .

Për hollsi, shih skicat 1 dhe 2.

## 3. Niveli i tretë

Niveli i tretë përfshin karakteret që mund t'i përftohsh tue ndrydhë njikohësisht **AltGr** dhe një buton tjetër. Në skicë, karakteret e këtij niveli janë të shënueme me ngjyrë të kuqe n'anën e djathtë të butonit.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Simbas standardit ndërkombtar ISO/IEC 9995-1, të gjitha karakteret e togut parsor duhet të shënohen n'anën e majtë të butonit. Karakteret e nivelit të tretë shënohen poshtë karaktereve të nivelit të parë.

AltGr ndodhet menjherë në të djathtë të tastit të hapsinës (*space bar*). Butoni *Alt* në të majtë të hapsinës nuk kryen funksionin e AltGr-së. Në disa raste, mund të ndrydhësh njikohësisht *Ctrl* dhe *Alt* në vend të AltGr-së.<sup>3</sup>

Tue mbajtë ndrydhë AltGr-në, mund të përftohen këto karaktere:

- AltGr + 4 = € – shenja e valutës Euro
- AltGr + 7 = { – kllapa gjarpnore hapëse
- AltGr + 8 = } – kllapa gjarpnore mbyllëse
- AltGr + 9 = [ – kllapa kandore hapëse
- AltGr + 0 = ] – kllapa kandore mbyllëse

Në tastierat e standardit ndërkombtar (ISO) që kanë një buton shtesë në mes të Z-së dhe ndërruesit të majtë (*Shift*), AltGr + [butoni shtesë] jep shenjën për shkallë ose gradë (°).

Këto bashkëdyzime çelësash funksionojnë në të dy përvijimet Plisi D1 dhe Plisi D2. Për karaktere të programueme vetëm te Plisi D2, shih skicën dhe lexo udhëzimet në vijim.

#### a. Karakteret e plota

Shih skicën 2.

#### b. Çelësat e vdekun

T'ashtuqejtunit «çelësa të vdekun» (*dead keys*) shërbejnë për të përfutue germa të veçanta, zakonisht me theks ose diakritike. Kur shtypet një çelës i vdekun, n'ekran nuk shfaqet kurrfarë ndryshimi. Por karakteri vijues ndryshon mvarsisht nga rregullat që i përcakton çelësi i vdekun.

Për ta përfutue një germë të veçantë me theks ose diakritike – si p.sh., ö ose š – duhet me i ndjekë dy hapa:

1. Hapi i parë asht me zgjedhë theksin ose diakritiken dhe
2. Hapi i dytë asht me ndrydhë butonin me germën së cilës don me ia shtue theksin ose diakritiken.

Për ta zgjedhë një theks ose diakritike, duhet me shtypë një çelës të vdekun.

Te Plisi D2, çelësat e vdekun ndodhen në nivelin e tretë. Për t'i përdorë çelësat e vdekun, duhet me i ndrydhë njikohësisht AltGr-në dhe butonin që e përmban çelësin e vdekun. Në skicë, çelësat e vdekun dallohet lehtë, meqë përmbajnë një shenjë – theks ose diakritike – të vendosun bashkë me një rreth me pika (○).

Pra, njëherë duhet me shtypë çelësin e vdekun e pastaj germën bazë. Për shembull, p.sh.:

- AltGr + ç pastaj *a* = á
- AltGr + j pastaj *s* = š
- AltGr+ w pastaj *c* = č

<sup>3</sup> Përdoruesit duhet të kenë kujdes kur përdorin programe të caktueme (si p.sh., përpunuesit e tekstit Microsoft Word dhe Corel WordPerfect), të cilat mund të përdorin bashkëdyzimin *Ctrl* + *Alt* në shkurtesa për komandat të caktueme. Corel WordPerfect mund të përdor edhe butonin *AltGr* në shkurtesa të tilla. Përdoruesit e atyre programeve zakonisht kanë mundësi t'i ndryshojnë parametrat e shkurtesave.

- AltGr + apostrof ( ' ) pastaj  $d = \mathring{d}$

Përvijimi Plisi D2 lejon me i shtue diakritike gati çdo germe t'alfabetit bazë latin (prej 26 shkronjash).

## B. TOGU DYTJOR

Toгу dytsor përmban karaktere shtesë me përdorim të posaçëm. Për t'i përfutue ato karaktere, përzgjedh çelësin e vdekun të shënuem me *shenjën kryq të shumzimit ( x )*. Për ta ba këte, shtyp njikohësisht **AltGr** + *theksi i randë ( ` )*. Butoni për theksin e randë (akut) ndodhet në skajin e majtë të rreshtit të parë, para numrit 1.

Shtyp pastaj një karakter që tabelën e maposhtme ndodhet në shtyllën e parë për ta përfutue karakterin nga shtylla e dytë.

Baza	Jep	Përshkrim
'	ə	<i>schwa</i> e vogël
"	Ә	<i>schwa</i> e madhe
,	...	tri pika (elips)
.	·	shenja e shumzimit, mespika (interpunkt)
\		shkop i premë
=	¬	shenja e mohimit
A	Æ	
a	æ	
B	'	thojëz njëfishe mbyllëse
b	”	thojëz dyfishe mbyllëse
ç	f	<i>s</i> e gjatë e vogël
D	Ð	germa <i>edh</i> e madhe
d	ð	germa <i>edh</i> e vogël
E	Ǝ	
e	œ	
i	ı	<i>i</i> pa pikë
L	Ł	
l	ł	
m	μ	mikro
O	Ø	
o	ø	
P	Ɔ	germa <i>thorn</i> e madhe
p	ɔ	germa <i>thorn</i> e vogël
q	°	shkallë/gradë
r	®	markë e regjistrueme
t	™	<i>trademark</i>
V	‘	presje e rrotullueme, okina oqeanike, thojëz njëfishe e epërme
v	“	thojëz dyfishe e epërme
X	,	thojëz njëfishe e poshtme



x	„	thojëz dyfishe e poshtme
Z	ß	germa eszet e madhe
z	ß	germa eszet e vogël
*	×	shenja kryq e shumzimit
hapsinë	NNBSP	hapsinë e ngushtë jondamëse ( <i>narrow non-breaking space</i> )